



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

**Drejtoria për Arsim**  
Odeljenje za Obrazovanje  
Department for Education



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu

**Raport vjetor i punës**  
**(Janar – Dhjetor, 2022)**

Nr. l prot. 08 Më Dt. 04.01.2023  
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

### Hyrje

Drejtoria për Arsim gjatë gjithë vitit 2022 ka zhvilluar aktivitete dhe ka punuar në përputhje me planifikimet e bëra sipas planit vjetor të punës. Në këtë raport janë paraqitur synimet, qëllimet, punët dhe aktivitetet kryesore gjatë gjithë vitit 2022 dhe synimet për vitin e ardhshëm.

#### Synimet kryesore e DKA-së për vitin 2022 ishin:

- Funksionalizimi i plotë i Aktiveve Profesionale dhe Këshillave Drejtuese në secilën shkollë;
- Riparimet në shkolla dhe investimet në efikasitet të energjisë në objektet shkollore;
- Investime për përfundimin e plotë për ndërtimin e 3 çerdheve për fëmijë;
- Vazhdimi i projekteve për përfundimin e ndërtimit të shkollave të filluara nga vitet e mëparshme;
- Fillimi i ndërtimit të shkollave të reja;
- Furnizimi i shkollave me libra, pajisja me mjete konkretizimi e laboratorike dhe teknologji informative.
- Veprime të duhura për të përmirësuar performancën e sistemit edukativo arsimor në komunën tonë.

#### Qëllime kryesore gjatë këtij viti, kishim:

- Ngritjen e cilësisë së procesit edukativo-arsimor në shkollat e të gjitha niveleve;
- Përmirësimin e infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme të institucioneve edukativo arsimore;
- Zhvillimin e aktiviteteve të shumta kurrikulare dhe jashtëkurrikulare;
- Funksionimin sa më të mirë të organeve drejtuese të shkollave;
- Ngritjen dhe zhvillimin profesional të kuadrit arsimor.

#### Objektivat tona të përhershme, që karakterizuan edhe këtë vit, janë:

- Përmirësimi i nivelit të mësimdhënies dhe të nxënësve në të gjitha shkollat;
- Zvogëlimi deri në minimum i mungesave të pa arsyeshme të nxënësve dhe mësimdhënësve;
- Ndërtimi i objekteve të reja shkollore dhe objekteve parashkollore (çerdheve);
- Riparimet e objekteve shkollore;

- Rregullimi i hapësirave të brendshme dhe të jashtme të shkollave;
- Zhvillimi i aktiviteteve të shumta jashtë kurrikulare në nivel shkolle dhe komune;
- Bashkëpunimi me komunitetin dhe me OJQ-të, aksionet vullnetare;
- Integrimi në procesin edukativo-arsimor i të gjithë fëmijëve të të gjitha komuniteteve pa dallim dhe fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

## AKTIVITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR ARSIM GJATË VITIT 2022

Gjatë gjithë vitit 2022 në kuadër të DKA-së u realizuan aktivitete, të cilat i kemi shkoqitur sipas muajve të vitit, siç vijon:

### Janar

Më 10 janar ka filluar procesi mësimor i vlefshëm për periudhën e dytë të vitit shkollor në të gjitha shkollat e komunës sonë. Për të parë nga afër fillimin e gjysmëvjetorit të dytë, ishim për vizitë në SHML “Ukshin Hoti” në Krushë të Madhe. Kemi ndërmarrë veprimet e duhura në objektin e shkollës së mesme profesionale, në mënyrë që objekti i kësaj shkolle të ngrohet në mënyrë të vazhdueshme. Në Shfmu “31 Marsi” në Guri të Kuq, janë kryer punimet e fundit të riparimit të një pjese të nyjeve sanitare nga kompania e kontraktuar. Kemi qenë në terren tek objekti i çerdhes për fëmijë në Krushë të Madhe së bashku me ekipin e KEDS-it, për t'i ndërmarrë veprimet e sigurimit të Pëlqimit Elektroenergjetik. Më 17 janar kemi mbajtur një takim me drejtorët e shkollave, kryetarët e Këshillave Drejtuese të Shkollave (KDSH) dhe me Koordinatorët e Cilësisë (KC) të secilës shkolle. Kemi kontaktuar me operatorët e kontraktuar për rifillimin e punimeve në projektet në vazhdim. Nga KEDS-i, kemi marrë konfirmimin se është bërë gati Pëlqimi Elektroenergjetik (PEE) për fuqinë e angazhuar të energjisë elektrike për objektin e çerdhes në Krushë të Madhe dhe 2 objekteve të tjera të parashikuara të ndërtohen në të ardhmen. Kemi hapur konkursin për bursa studentore dhe menjëherë ka filluar edhe aplikimi i studentëve. Poashtu, DKA ka hapur edhe disa konkurse të tjera për mësimdhënës, të planifikuara për t'i plotësuar nevojat për kuadër profesional gjatë tërë vitit. Në çerdhen për fëmijë “Tulipanët” pas furnizimit me perde, u bë edhe furnizimi me tepihë për dysheme. Kemi vazhduar me organizimin dhe mbajtjen e garave shkollore të vlefshme për Olimpiadën Matematike dhe për Garën Republikane të Fizikanëve të Rinjë. Në koordinim me DKRS dhe Këshillin Organizues u kujdesëm për mbarëvajtjen e aktiviteteve të parapara për manifestimet e Flakës së Janarit. Gjatë javës së fundit të janarit gjendja pandemike u përkeqësua sepse ka patur mbi 80 nxënës të infektuar me covid. Si rezultat i kësaj gjendjeje, 4 paralele të shkollave të ndryshme kanë kaluar në mësim online, e poashtu Task Forca e shkollës “Isa Boletini” ka kaluar në skenarin C (mësim online), pasi mbi 50 nxënës të kësaj shkolle ishin të infektuar.

### Shkurt

Ka vazhduar aplikimi i studentëve në konkursin për bursa studentore dhe ky proces do të vazhdonte deri më 11 shkurt 2022 . Shpallëm konkursin për 2 asistentë/e për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta, bazuar në vendimin e MASHTI-it. Kemi filluar përgatitjet për mbajtjen e Kuizit të Diturisë për lëndën e Historisë me nxënësit e klasave të 12-a, për nder të festës së 17 shkurtit. Kemi filluar me përgatitjet për hartimin e Pakos Pedagogjike për klasat 6 deri 12 dhe

për këtë arsye kemi mbajtur një takim me përfaqësuesit e Aktivave Profesionale të fushave kurrikulare të shkollave. Gjatë javës së parë të shkurtit, poashtu, kemi shpërndarë lekturat dhe librat në bibliotekat e 8 shkollave të komunës sonë. Kemi riparuar pompat termike të ngrohjes qendrore në shkollën Skender Kastrati, të cilat patën një prishje, ndërsa në shkollën profesionale me ndihmën e ekipeve të KRU “Gjakova” është gjetur defekti i rrjedhjes dhe humbjeve të sasisë së ujit në rrjetin instalues. Në shkollën “Vëllezërit Frashëri” në Drenoc dhe në paralelen e ndarë të saj në Senoc ka përfunduar instalimi i kamerave të sigurisë. Më 12 shkurt mbajtëm Garën Komunale të Fizikanëve të Rinj me nxënësit e klasave 9, 10, 11 dhe 12 të të gjitha shkollave. Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës janë organizuar dhe kanë filluar të mbahen ligjërata me karakter edukativ dhe vetëdijësues me nxënësit e disa shkollave. Për nder të 17 shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Kosovës, u organizuan dhe u mbajt Kuizi i Diturisë për lëndën e Historisë me nxënësit e klasave të 12-a, dhe gara për pikturën me të mirë. Kemi pranuar një donacion të vogël nga OSBE për Qendrën Arsimore në shkollën “Katër Dëshmorët” në Ratkoc, ku zhvillohet mësim shtesë për fëmijët e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë. Më 19 shkurt, organizuam dhe mbajtëm Garën Komunale të Olimpiadës Matematike me nxënësit e klasave 9, 10, 11 dhe 12 të të gjitha shkollave. Në objektin e shkollës “Tre Dëshmorët” në Vrajakë/Bratotin kanë vazhduar punimet në suvatimin e mureve të brendshme të saj, pas montimit të dritareve. Më 27 shkurt, i dërguam për të marrë pjesë në Garën Republikane të Fizikanëve të Rinj 4 nxënësit fitues nga Gara Komunale të klasave 9, 10, 11 dhe 12.

### **Mars**

U bënë përgatitjet e nevojshme dhe u mbajt manifestimi festiv për shënimin e 7 Marsit – Ditës së Mësuesit dhe Shkollës së parë Shqipe. Kemi përfunduar shpërndarjen e mjeteve të konkretizimit dhe pajisjeve laboratorike në 12 shkolla. Mbajtëm një takim me drejtorët e shkollave dhe me koordinatorët e cilësisë, ku u bë prezantimi i projektit “SchoolMe”. Mbajtëm një takim me menaxherët e projektit nga MAPL për ndërtimin e shkollës ‘SADEDIN HAJDA’, me të cilët u konsultuam rreth punëve përfundimtare që duhet bërë në këtë objekt. Kemi bërë shkresë zyrtare në MASHT, në të cilën kemi dërguar të dhëna për çerdhet e reja dhe kemi kërkuar ndihmë për funksionalizimin e tyre me staf adekuat. Kemi vizituar punimet që po bëhen në çerdhen për fëmijë në Xërxë dhe punimet e sapo përfunduara të riparimeve në objektin e SHML “12 Maji” ku u shtruan dyshemetë e katit përdhesë. Poashtu, në Retijë të Poshtme ka përfunduar riparimi i kulmit të depos së druve. U mbajt edhe takimi i rregullt mujor me drejtorët e shkollave.

### **Prill**

Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës kanë vazhduar të mbahen ligjërata me karakter edukativ dhe vetëdijësues me nxënësit e disa shkollave . Në çerdhen për fëmijë në Xërxë janë zhvilluar punime brenda objektit e poashtu edhe në objektin e shkollës “Tre Dëshmorët” në Vrajakë/Bratotin kanë vazhduar punimet. Kemi bërë shkresë zyrtare në MASHT, në të cilën kemi dërguar të dhëna për çerdhet e reja dhe kemi kërkuar ndihmë për funksionalizimin e tyre me staf adekuat. Në fillim të prillit përfundoi periudha e dytë e procesit mësimor dhe në vazhdim ishte pushimi pranveror. Kemi filluar përgatitjet për organizimin dhe mbajtjen e Testit Ndërkombëtar PISA dhe përgatitjet për Testin e Arritshmërisë për klasat e nënta. Kemi bërë shkresë zyrtare në MASHT, me të cilën kemi kërkuar edhe njëherë që sa më shpejtë të bëhet furnizimi me inventar i shkollave dhe çerdheve të reja të ndërtuara.

Ka vazhduar procesi mësimor i vlefshëm për periudhën e tretë të këtij viti shkollor, me ç'rast, nxënësit e shkollave "Bekim Sylka" dhe ata të ciklit të lartë të shkollës "Isa Boletini" kanë vazhduar të mbajnë mësim në objektin e ri të shkollës "Sadedin Hajda" dhe në objektin e Shkollës së Mesme Profesionale. Për nder të 22 prillit – Ditës së Tokës, nxënësit dhe mësimdhënësit e të gjitha shkollave i janë bashkuar aksionit vullnetar për pastrim dhe pati një pjesëmarrje masive. DKA nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Organizatën ABSM me qendër në Zvicër dhe me degën e saj në Gjakovë, e cila funksionon si qendër edukative. Patëm një takim edhe me përfaqësues nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar "JICA", me të cilët bashkëbiseduam për nisjen e projektit "Programi i riciklimit të mbeturinave dhe edukimi mjedisor". Ky projekt do të realizohet me nxënësit e 2 shkollave të komunës sonë. Në paralelen e ndarë të shkollës "Rudolf Walther" në Dobidol, janë zhvilluar punime në rregullimin e kanalizimit të objektit të shkollës dhe kyçjes së tij me rrjetin kryesor të kanalizimit të fshatit. U mbajt një sesion informues për maturantët nga profesorët e Universitetit të Prizrenit lidhur me programet e studimit që ofron ky universitet.

## Maj

U mbajt një takim me MASHT-in dhe u bënë përgatitjet e nevojshme për shkuarjen në ekskurzion të maturantëve. Ka vazhduar procesi mësimor i vlefshëm për periudhën e tretë të këtij viti shkollor, ndërkohë që procesi mësimor për maturantët përfundoi më 20 maj. Në objektin e vjetër të Shkollës "Isa Boletini" kanë vazhduar punimet në ndërmarrjen e masave të eficiencës së energjisë, ndërkohë që këto punime kanë filluar edhe në Shkollën "Bekim Sylka". Zhvilluam edhe një takim konsultativ me përfaqësues të projektit "SchoolMe" për hapat që do t'i ndjekim për të filluar së zbatuari këtë projekt. Në MASHT kemi nënshkruar marrëveshjen për fillimin e zbatimit të projektit "EYE" për themelimin e Qendrës së Karrierës në Shkollën e Mesme Profesionale. Në shkollën Rudolf Walther në Dejnë kemi pranuar një donacion të vlefshëm nga një bashkatdhetar, në vlerë prej 8500€, ku përfshihen 10 Smart Tv, 6 fotokopjues dhe një videoprojektor. U mbajt testi PISA në 9 shkolla të komunës sonë. Kemi aplikuar në një projekt në bashkëpunim me Caritas-in Zvicëran, përmes të cilit në 3 shkolla të mesme të komunës sonë do të themelohen eko-klubet e të rinjve. Tashmë jemi përfitues të këtij projekti dhe marrëveshja do të nënshkruhet së shpejti. Mbajtëm Garën Komunale të diturisë me nxënësit e klasave të 6-a, 10-a dhe 11-a, në lëndët Gjuhë shqipe, gjuhë angleze, Kimi, Biologji Ekologji e Mjedis. Ndërkohë që kemi bërë edhe përgatitjet tjera për mbajtjen e Garës Komunale të Diturisë edhe me lëndët dhe klasat tjera. Nisëm procedurën për realizimin e projektit "Furnizimi i shkollave me teknologji informative – Tabela Digjitale".

## Qershor

Kanë filluar punimet në ndërtimin e fushës sportive në oborrin e shkollës "31 Marsi" në Guri të Kuq. Pas lidhjes së kontratës kanë filluar dhe po vazhdojnë punimet në instalimin e ujit, rrymës dhe kanalizimit për çerdhen e fëmijëve në Krushë të Madhe. Kemi mbajtur një takim me koordinatorët dhe administratorët e Provimit të Maturës dhe Testit të Arritshmërisë për përgatitjet që duhej bërë. Me rastin e 1 qershorit - Ditës së Fëmijëve, së bashku me DKRS-në

dhe Shoqatën “Hareja” mbajtëm një manifestim festiv. Shpallëm rezultatet e përfituesve të bursave studentore. U mbajt Testi i Arritshmërisë për nxënësit e klasave të IX-ta, i cili u zhvillua në 4 qendra dhe në këtë test morën pjesë 710 nxënës. Ky test, u zhvillua në 2 pjesë, përkatësisht, më 4 qershor dhe më 14 qershor. Patëm edhe aktivitete përkujtimore dhe Festën e Ditës së Shkollës së Muzikës në 10 vjetorin e themelimit të saj. Në objektin e vjetër të Shkollës “Isa Boletini” dhe në Shkollën “Bekim Sylka” kanë vazhduar punimet në ndërmarrjen e masave të efijencës së energjisë. Në SHML “Xhelal Hajda-Toni” janë zhvilluar punime në projektin e instalimit të ngrohjes qendrore.

Organizuar nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe QKMF, janë zhvilluar vizita sistematike mjekësore në shkollat fillore të komunës sonë. Më 10 qershor përfundoi mësimi për nxënësit e klasave 9, 10 dhe 11. U mbajt Gara Komonale e Diturisë në disa lëndë mësimore me nxënësit e klasave të katërta, të gjashta, të shtata dhe të teta. Më 18 qershor, u mbajt Provimi i Maturës, në të cilin morën pjesë 413 maturantë. Prej tyre, pragon e kalueshmërisë e arritën 280 maturantë, ose shprehur në përqindje 67,8 %, ndërsa nuk e kaluan 133 maturantë, ose shprehur në përqindje 32,2 %.

## **Korrik**

Në objektet e shkollave “Isa Boletini” dhe “Bekim Sylka” kanë vazhduar punimet në ndërmarrjen e masave të efijencës së energjisë, përkatësisht në rregullimin e ngrohjes qendrore. Kanë vazhduar punimet poashtu edhe në instalimin e ngrohjes qendrore në objektin e SHML “Xhelal Hajda-Toni” dhe në objektin e ri të shkollës “Tre Dëshmorët” në Vrajakë /Bratotin, ku është bërë izolimi i jashtëm i objektit. Ka filluar furnizimi me inventar i 4 objekteve të reja të shkollave. Në javën e parë të korrikut u bë pajisja me inventar i Shfmu “Liria” në Fortesë dhe në Shfmu “Milaim Krasniqi” në Kaznik. Kemi përgatitur raportin e punës së DKA-së për përfundimin e vitit mësimor, që e prezantuar në mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal. Kemi nisur procedurën për projektin e drenazhimit të fushës sportive të jashtme në oborrin e SHML “12 MAJI” në Ratkoc. Kemi përgatitur dhe dërguar 5 kërkesa zyrtare drejtuar MASHTI-t. Kemi nisur procedurën për projektin e ndërtimit të objektit të SHFMU “Hamëz Thaçi” në Xërxë, e poashtu edhe për projektin e riparimit të nyjeve sanitare në Shfmu “Sapniqi” në Sapniq.

Përveç në objektet e shkollave “Isa Boletini” dhe “Bekim Sylka” dhe “12 Maji”, ku kanë vazhduar punimet në ndërmarrjen e masave të efijencës së energjisë, në fund të muajit korrik filluan punimet në ndërmarrjen e këtyre masave edhe në paralelen e ndarë të Shfmu “Skënder Kastrati” në Gexhë. Në bashkëpunim me grupin punues, kemi përgatitur një raport vlerësues për materialin mësimor për edukim mjedisor dhe riciklim të mbeturinave dhe atë raport vlerësues e kemi dërguar në organizatën JICA si pjesë e projektit të bashkëpunimit tonë, që do të zbatohet në 2 shkolla të komunës sonë. Janë bërë përgatitjet e duhura për pranimin dhe grumbullimin e teksteve mësimore.

## **Gusht**

Në fillim të këtij muaji i kemi plotësuar me të dhëna formularët për Institucionet edukativo arsimore në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK). Kemi patur një takim në MASHTI lidhur me përgatitjet që duhet bërë për fillimin e vitit të ri shkollor, për tekstet mësimore dhe për

afatin plotësues të regjistrimit të nxënësve në klasat e dhjeta. U bë ekzekutimi i bursave për 169 studentët përfitues. Kemi kontaktuar me zyrtarët e departamentit të Infrastrukturës dhe objekteve arsimore në MASHTI dhe kemi kërkuar informacion se kur do të fillojnë procedurat e prokurimit për 2 projektet, për projektin e ndërtimit të çerdhes në qytet dhe për projektin e ndërtimit të shkollës në Pastasel. Përkundër faktit që ne disa herë kemi kërkuar fillimin e këtyre projekteve dhe i kemi dërguar me kohë dokumentet e nevojshme, siç janë kopja e planit të parcelave, pëlqimet urbanistike, certifikatat e pronësisë dhe të tjera, përgjigja që morëm nga zyrtarët e ministrisë, ishte: “Do t’ju njoftojmë për fillimin e procedurave të prokurimit, pasi të shqyrtohet mundësia buxhetore nga MASHTI. Gjithashtu, nga zyrtarët e departamentit të infrastrukturës në MASHT, kërkuam pajisjen me inventar të 3 çerdheve të reja dhe na premtuan se furnizimi me inventar do të ndodhë së shpejti. Kemi siguruar vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Pëlqimit Elektroenergjetik nga KEDS për Çerdhen në Krushë të Madhe pas kërkesës që kemi bërë. Kemi nisur procedurën e prokurimit për ndërtimin e aneksit të shkollës fillore “ Katër Dëshmorët” në Ratkoc dhe gjithashtu kemi nisur procedurat për projektin e renovimeve në shkollën ‘Bekim Sylka”.

#### **Shtator**

Në objektet e shkollave “Isa Boletini” , “Bekim Sylka” dhe “12 Maji”, kanë vazhduar punimet në ndërmarrjen e masave të efijencës së energjisë, por, këto punime për shkak të zhagitjeve nga kompanitë punëkryese, nuk janë kryer në kohën e paraparë, në mënyrë që objektet të jenë të gatshme më 1 shtator. Në shkollën fillore “Rilindja’ në Çifllak përfunduan punimet në projektin e ndërtimit të parkingut dhe rrethojës së oborrit të shkollës. Viti i ri shkollor nuk filloi më 1 shtator edhe kësaj radhe, për shkak të grevës së nisur nga SBASHK-u dhe BSPK-ja, që nga data 25 gusht 2022. Më 13 shtator morëm pjesë në një sesion informues të organizuar nga GIZ - gjerman dhe Organizata RYCO lidhur me një projekt për të rinjtë e shkollave të mesme të larta, në të cilin këto shkolla do të aplikojnë. Si pasojë e reshjeve të mëdha të shiut, u përmyt nga uji shkolla në Sapniq, por objekti i shkollës dhe oborri i saj u pastruan nga kompania “Vetoni” dhe nga njësitë i zjarrfikësve i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim. Në objektin e Shkollës “12 Maji” në kuadër të efijencës kanë përfunduar punimet në riparimin dhe izolimin e kulmit, ndërkohë u punua në izolimin e mureve të jashtme të objektit.

#### **Tetor**

Viti i ri shkollor filloi më 3 tetor, pas pezullimit të grevës nga SBASHK-u dhe BSPK-ja, e cila kishte filluar që nga data 25 gusht 2022. Pas lidhjes së kontratës për lëndë ngohëse, ka filluar furnizimi i objekteve shkollore me dru dhe pelet. Me Aktivat Profesionale të të gjitha fushave kurrikulare kemi mbajtur takimin e radhës, në të cilin përfaqësuesit e këtyre aktiveve morën përsipër të kryejnë punë në zgjerimin e Pakos Pedagogjike edhe për klasat e larta (9-12). Kemi pranuar një donacion me libra (përmbledhje poezish) nga familja e shkrimtarit të ndërë Hysni Gashi. Ky donacion dedikuar shkollave të komunës sonë u nda përmes Shoqatës “Arbëria”. Është lidhur kontrata për ndërtimin e objektit të ri të Shfmu “Hamëz Thaçi” në Xërxë. Ka përfunduar furnizimi i të gjitha objekteve shkollore me dru dhe pelet . U mbajt trajnimi dy ditor i

Eko klubeve të 3 Shkollave të Mesme të Larta, në kuadër të fillimit të zbatimit të projektit “Të rinjtë për Mjedisin”. Kemi përgatitur raportin 3 mujor të DKA-së dhe kemi prezantuar në seancën e Kuvendit Komunal Informatën e DKA-së për fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023. Procesi mësimor u mbajt rregullisht, por zëvendësim të ditëve të humbura të shtunën nuk pati.

### **Nëntor**

Në objektin e shkollës “12 Maji” në kuadër të efijencës kanë vazhduar punimet në izolimin e mureve të jashtme dhe ka vazhduar montimi i dritareve. Punime poashtu, por me ritëm të ngadalshëm kanë vazhduar edhe në shkollën “Isa Boletini”, “Bekim Sylka” dhe në paralelen e ndarë të shkollës “Skënder Kastrati” në Gexhë. Punët kanë vazhduar edhe në Shfmu “Tre Dëshmorët” në Vrajakë-Bratotin dhe në Shfmu “Bajram Curri” në Krushë të Madhe. Me vënien e gurthemelit, filloi puna në ndërtimin e objektit të ri të SHFMU “Hamëz Thaçi” në Xërxë. Kanë filluar punimet në riparimin dhe inventarizimin e Qendrës së Karrierës në Shkollën Profesionale në kuadër të projektit “YENI”. Është lidhur kontrata për projektin “Ndërtimi i aneksit të objektit të SHFMU “Katër Dëshmorët” në Ratkoc. Janë zhvilluar vizita sistematike shëndetësore tek nxënësit e klasave të para dhe të pesta të shkollave fillore. Nga Policia e Kosovës kanë vazhduar të mbahen ligjërata vetëdijësuese për sigurinë në përdorimin e internetit nga nxënësit e klasave të 7, 8 dhe 9. Kanë përfunduar instalimet elektrike të kalldajës në SHFMU “Skënder Kastrati” në Malësi të Vogël dhe ky problem u zgjidh. Ka përfunduar projekti i rregullimit të fushës sportive në oborrin e shkollës “12 Maji” në Ratkoc. Ka filluar furnizimi me inventar për objektin e ri të shkollës në Retijë. Më 19 nëntor u mbajt Gara Komunale e Olimpiadës Matematike ndërmjet nxënësve të klasave 9, 10, 11 dhe 12. Pas përfundimit të projektit për rregullimit të fushës sportive në oborrin e shkollës “12 Maji” në Ratkoc, u bë përrurimi i saj. Ka vazhduar furnizimi me inventar për objektin e ri të shkollës në Retijë dhe në prag të festës së 28 Nëntorit, u bë përrurimi i kësaj shkolle. Furnizimi me inventar u bë edhe për Shfmu “Faik Konica” në Celinë. Në të gjitha shkollat e komunës sonë u mbajtën manifestime kulturore dhe artistike për nder të Festës së 28 Nëntorit.

### **Dhjetor**

Më 3 dhjetor, dërguam në Garën Republikane të Olimpiadës Matematike 8 nxënësit fitues të Garës së Olimpiadës Komunale. Nga kjo garë, nxënësja jonë nga klasa e 11-të e Shkollës së Mesme të Lartë “Xhelal Hajda-Toni” fitoi vendin e tretë. Punimet kanë filluar edhe në projektin e ndërtimit të objektit të ri të Shfmu “Hamëz Thaçi” në Xërxë, ndërsa në Shfmu “Katër Dëshmorët” përruam fillimin e punimeve. Është lidhur kontrata për projektin e rregullimit të ngrohjes qendrore në objektin e SHFMU “Rudolf Walther” në Dejnë dhe punëkryesi menjëherë ka filluar dhe ka realizuar këtë projekt. Me Caritasin Zvicëran mbajtëm trajnimin dy ditor me mësimdhënësit e 3 shkollave të mesme të larta, pjesëtarë të Eko Klubeve. Ndërkohë, gjatë këtij muaji rregulluam edhe këndin e lodrave për fëmijë në oborrin e Çerdhes për Fëmijë “TULIPANËT” në qytet dhe përruam objektin e ri të Çerdhes për Fëmijë në Xërxë. Poashtu, në muajin dhjetor përruam edhe Qendrën e Dytë Arsimore për Komunitete në Shkollën “Gëzim Hamza-Piktori”, e cila u pajis me mjete konkretizimi, laboratorike dhe teknologji informative.

Të hyrat sipas muajve në Çerdhen e Fëmijëve “TULIPANËT” deri në datën e përpilimit të këtij raporti vjetor i kemi paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Të hyrat e çerdhes së fëmijëve  
"TULIPANËT" në Rahovec  
për vitin 2022

Muaji	Të hyrat
Janar	3.195.00 €
Shkurt	3.420.00 €
Mars	3.540.00 €
Prill	3.690.00 €
Maj	3.690.00 €
Qershor	3.495.00 €
Korrik	1.035.00 €
Gusht	0.00 €
Shtator	0.00 €
Tetor	3.165.00 €
Nëntor	3.390.00 €
Dhjetor	2.805.00 €
Gjithsej	28.230.00 €

• Synimet kryesore të DKA-së për vitin e ardhshëm janë:

- Funkcionalizimi i plotë i 3 çerdheve të reja në Krushë të Madhe, Xërxë dhe Ratkoc;
- Funkcionalizimi i plotë i aktivave profesionale (AP) në secilën shkollë;
- Vazhdimi i riparimeve në shkolla dhe investimet në efikasitet të energjisë në objektet shkollore sipas kontratave që burojnë nga Marrëveshjet e Mirëkuptimit me Fondin e Kosovës për Efikasitet të Energjisë;
- Vazhdimi i projekteve për ndërtimin e shkollave të reja të filluara në vitin 2022 ;
- Vazhdimi i furnizimit të shkollave me libra dhe vazhdimin me pajisjen e tyre me mjete konkretizimi, laboratorike dhe teknologji informative;



Avni Morina

Drejtor i DKA-së

*Avni Morina*